

RELACION ARGUMENTIMI
OBJEKTI: SHITESE KONTRATE SISTEMIM RRUGËSH BLOKU TEK ISH FERMA
LAGJJA NR. 1 POGRADEC

I. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Bloku objekt sistemimi ndodhet në pjesën juglindore të qytetit dhe kufizohet me:

Në veri ---- rruga "Korçës"

Në jug ----- Rruga "Industriale"

Në perëndim-----"Zona Ish industriale dhe Ish parku"

Në Lindje ----- rruga "Unazë"

Rrjeti rrugor brenda lagjes ka një shtrirje vertikale me rrugën "Korçës" dhe "Unazë" me degezime rrugësh brenda bllokut.

II. GJENDJA EKZISTUESE

a) Të dhëna demografike.

Kjo lagje është një nga lagjet e reja të qytetit të krijuara pas viteve 1990 me banesa 2-4 kate kryesisht individuale me një numër prej rreth 1000 banorësh. Kufizohet në pjesën veriore me një nga akset kryesore të qytetit siç është rruga e Korçës në lindje rruga unazë, dhe në jug me zonën e industriale të qytetit. Rrugët e lagjes shërbejnë si lidhje edhe për levizjen e banorëve drejt qendrës dhe pjesëve të tjera të qytetit.

b) Të dhëna për infrastrukturën.

Rjeti rrugor ekzistues shtrihet gjatë gjithë sipërfaqes së lagjes duke e ndarë atë në disa pjesë dhe në shumë degëzime. Rrugët janë të pa asfaltuara, dhe tërësisht të dëmtuara me gropëzime të theksuara në gjithë sipërfaqen dhe ndikojnë negativisht si në aspektin teknik ashtu dhe në atë mjedisor.

Rjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza (U.Z) është trajtuar në rrugën me drejtim pingul me rrugën e "Korçës" segmenti "a" të emërtuar në projekt. Ky rrjet kanalizimesh është trajtuar kryesisht në segmentet e rrugëve në drejtim pingul me rrugën e "Korçës" si pjesë e projektit të kanalizimeve të U.Z të qytetit me të gjitha elementet përbërës të tij. Mungon krejtësisht rrjeti i kanalizimeve të ujërave sipërfaqësore, rrjedhja e pakontrolluar e të cilave, në rastet e reshjeve kanë ndikuar në ndotjen e qytetit.

Për të gjitha këto, lind e domosdoshme ndërhyrja me fonde publike për zbatimin e **projekteve të sistemimit** në këtë zonë e cila është e përfshirë në objektivat e programit të parashikuar në prioritetet e qeverisjes vendore për të bërë të mundur që edhe në këtë pjesë të zonës së banuar të krijohen kushtet për rritjen e cilësisë së jetës, përmirësimin e ambientit, peizazhit etj.

III. PROJEKTI I SISTEMIMIT SYNON:

Perfundimin e projektit tek Blloku I ish Fermes , me te gjithë elementet e nevojshem dhe kompletim I te gjithë gjurmes se projektit se bashku me segmentet sekondare. Për shkak të situatës ekzistuese të përshkruar më sipër si edhe për problemet e lehtësimit të lëvizjes së banorëve dhe mjeteve, lind e domosdoshme për të ndërhyrë në këtë zonë.

Krijimin e kushteve e parametrave për një përmirësim të kësaj zone në drejtim të:

- Përmirësimit të cilësisë së jetesës
- Përmirësimit të ambientit e peizazhit.
- Përmirësimit të qarkullimit të mjeteve të transportit dhe parkimet
- Lehtësimin e lëvizjes së qytetarëve

IV. TE DHENA SPECIFIKE

- Numri i rrugëve që trajtohen janë **8 segmente** sekondare
- Projekti konsiston në rehabilitimin dhe rikonstruksionin e rrugëve **ekzistuese** me **1 kors**
- Gjërësia e trupit të rrugëve varion nga **3 deri 5 m**
- Sipërfaqe e përgjithshme rrugë e trotuare është **2777 m²**
- Kanalizimi i ujrave të bardha **L = 533 ml**
- Trajtimi i ndriçimit realizohet në akset kryesore me ndriçim të lartë me kantelabra **h= 5**.
- Sistemi i ndriçimit është i kompletuar me sistemin e komandimit dhe mbrojtjes së rrjetit.

Për realizimin e projektit me zërat të mësipërm nevojitet një fond prej **23489567** lekë me TVSH

Investimi i kërkuar përveç se do të bëjë të mundur realizimin e objektit me gjithë elementet e tij , do të beje të mundur sistemimin në një bllok banimi me parametra bashkëkohore dhe përmirësim të kushteve të jetesës dhe të ambientit në tërësi.

Hartoi:

**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
SEKTORI I PROJEKTEVE TË INFRASTRUKTURËS URBANE**

Ark. Dhimitraq Gjata
Ing. Violeta Çekani
Ing. Ermira Xhaja